

Nr. 04/2025

Në bazë të Rregullores Respektive për punën e Komisionit të Ankesave të Federatës së Volejbollit të Kosovës, përkatësisht Nenit 5,7, 8,11,13 dhe 14 dhe të tjerave që përshkruhen në këtë Rregullore, lidhur më Ankesën e parashtruar nga K.V. “Peja” që përmban nr.protokoli 151/24 datë:30.12.2024 i përfaqësuar nga Avokati, Dukagjin M.Kërveshi ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor me Nr.prot;146/24, të datës 14.12.2024, Komisioni i Ankesave në përbërje, Gani Ibrahimimi kryetar, Agim Zuzaku anëtar dhe Driton Ramadani anëtar,në shqyrtimin kryesor me përgjegjësi dhe kompetencë mori:

V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT Ankesa e KV.”Peja” e protokoluar më datë 30.12.2024 Nr.151/24 si e bazuar; nga Komisioni i Ankesave dhe në bazë të kompetencave edhe të Nenit 7, pika 1.1 të Rregullores së punës të Komisionit të Ankesave e ndryshon vendimin e Komisionit Disiplinor VETËM, për Pika II, Pika V, Pika VI, Pika VII.

Ad/I- për Pika II: Komisioni për Shqyrtimin e Akesave , Arlind Kabashit , lojtar me nr.7, i KV “Peja”, i ulet dënimi i shqiptuar/masa disiplinore, nga 10 (dhjetë) vite në 7 (shtatë) vite Ndalim i pjesmarrjes në gara, si dhe dënohet me gjobë në lartësi prej 1,000 € (njëmijë euro)”.

Ad/I-për PikaV: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, Kaltrim Berishes (lojtar me Nr.2, i KV “Peja”, i ulet denimi i shqiptuar/masa disipinore nga 3 (tri) vite në 1(një)vit Ndalimi i pjesëmarrjes në gara, si dhe dënohet me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind euro)”.

Ad/I, për Pika VI: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, Dardan Husajt, lojtar me nr 18, i KV “Peja” i ulet dënimi i shqiptuar/masa disiplinore, nga nga 3 (tri) vite në 1 (një) vit ; Ndalimi i pjesëmarijes në gara si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 600 € (gjashtëqind euro)”.

Ad/I, për Pika VII: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, Gazmend Husajt , lojtar me nr.8, i KV “Peja”, i ulet dënimi i shqiptuar/masa disiplinore nga nga 1(një) vit në 7(shtatë) muaj ;Ndalimi i pjesëmarijes në gara, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 500 € (pesëqind euro)”.

II. MBETET NË FUQI pjesa e Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës Nr.prot;146/24, të datë 14.12.2024 për Pika I. Pika III, dhe Pika IV.

Ad/II, për pika I: Komisioni për Shqyrtimin e Akesave e Verteton Vendimin e Komisionit Disiplinor: Klubi i Vollejbollit (KV) “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, denohet me gjobë në lartësi prej 2,000 € (dymijë euro).

Ad/II, për pika III: Komisioni për Shqyrtimin e Anklesave, e Vërteton Vendimin e Komisioint Disiplinor: Leutrim Mujaj (Nr.1), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 10 vitesh, si dhe dënohet me gjobë në lartësi prej 1,000 € (njëmijë euro)”.

Ad/III, për pika IV: Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, e Vërteton Vendimin e Komisionit Disiplinor : Agron Nikqi, (Nr. 10), lojtar i KV “Peja”, për shkelje të rëndë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: “Ndalimi i pjesëmarrjes në gara në afat prej 3 vitesh, si dhe denohet me gjobë në lartësi prej 800 € (tetëqind euro)”.

III. DETYROHET Autoriteti i FVK, që konformë rregulloreve respektive në Federatën e Volejbollit të Kosovës t’i procedoj për Zbatim Vendimet nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave si Shkalla e Dytë e të cilat janë përfundimtare brenda FVK-së, rerspektivisht sipas Nenit 7 pika 3 e Rregullores në fuqi .

ARSYETIM

Komisioni i Ankesave, përmes administratës së FVK-së, ka pranuar Ankesën e KV “Peja” të datës 30.12.2024 me përfaqësues ligjor-avokat Dukagjin M.Kërveshio në afat ligjor, (tash e tutje “Ankesa”) e cila ka të bëjë me Vendimin e Shkallës së parë, përkatësisht Komisionit Disiplinor me nr.prot.146/24 të datë 14.12.2024 i cili ka të bëjë me dënimet për KV”Peja” dhe lojtarëve të ekpes KV. “Peja”.

Komisioni për shqyrtimin e Ankesave, në seancat e datë 31.12.2024; 08.01.2025 dhe të shqyrtimit kryesor të datë 11.01.2025 ka shqyrtuar Ankesën e KV. “Peja” dhe gjithë provat administrative, deklaratën e KV.”Peja”, deklaratat me shkrim të Lulzim Gërgurit, të Gazmend, Husaj, të Arlind Kabashi, të Agron Nikqit, të Dardan Husaj dhe gjithë dosjen e lëndës që përmban në përgjithësi edhe Video inqizimet amatore me emer rasti “Kupa”

Me kompetencë Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave kanë marrë pjesë në Vendimmarrje: Gani Ibrahim, kryetar, Agim Zuzaku, anëtar dhe Driton Ramadani, anëtar.

Komisioni ankesave, në përbërje të plotë, ka analizuar ankesën e KV “Peja”, ka pasur faktet në dispozicion dhe ato që janë relevante për rastin e ndodhur në Palestren “Bil Klinton”, më datë 1/12/2024 që ndodhi në Finalen e Kupës së FVK ndërmjet KV.”Peja” me KV. “Ferizaj”, dhe mbi bazën e fakteve dhe Rregulloreve në fuqi dhe mbi të cilat është artikuluar edhe vendimi i Komisionit Disiplinor konstaton dhe Vërteton si në dispozitiv të këtij Vendimi:

- Akesa e prashtruar nga KV. “Peja” pranë organit të pavaruar dhe vendimmarrës, kishte mjaft lëshime formalo-juridike.
- Akesa i është referuar vetëm ngjarjes, deklaratave dhe emrave, kurse në aspektin ligjor ka shumë mangësi, nga se nuk i referohet fare Rregulloreve respektive të FVK, që janë në fuqi !.,
- Ankesa Referohet te sejcila pikë ankuesi, gjëja se Komisioni Disiplinor nuk mundë të shqiptoj 2 (dy) masa.
- E kujtoj Ankuesin : se Rregullorja për procedurat dhe masat disiplinore të FVK-së, neni 6.6 po citoj:“Varësisht nga kundervajtjet, Komisioni përkatës mund të shqiptoj një apo dy masa disiplinore”
- Edhje përkundër se ankesa kishte shumë mangësi, ne si Komision i Ankesave për rastin, tani shumë publik u ndje i obliguar edhe nga aspekti edukativ, por edhe ligjor ta shqyrtoj dhe vlersoj rastin për sejcilin që është i anatemuar në Vendimin e Komisionit Disiplinor.

Komisioni i Ankesave ka gjetur edhe fakte shtesë: Leutrim Mujaj dhe Agron Nikqi, edhe më parë kanë qenë të dënuar nga Komisionet përkatëse, dëshmi kjo që Vendimin e Komisionit Disiplinor e bënë më bindës.

Në asnjë Deklaratë me shkrim, të cilat ishin uniforme, Komisioni i Ankesave nuk gjetëm një keqardhje për rastin, apo një kërkimfalje së paku për skenat e tilla.

Komisioni i Ankesave në bazë të provave shkresore për ndërmarrje të masave dhe shqiptim të gjobave dhe dënimeve nga Komisioni Disiplinor, ka ardhur në përfundim për Vertetimin e dënimeve, apo edhe uljen e dënimeve për sejcilin që kishte bazën juridike të arsyetuara me interes të përgjithshëm dhe Volejbollin në Kosovë.


Andaj, në bazë të kësaj që u tha më lart, Komision i Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit. Vendimi i Komisionit të Ankesave janë përfundimtare, në FVK

13/01/2025

Komisioni i Ankesave:

Agim Zuzaku, anëtar



Gani Ibrahimi, kryetar



Driton Ramadani, anëtar



Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 21 ditësh në Komisionin e Arbitrazhit Sportiv (KAS).

Vendimi t'u dërgohet:

1. KV Peja,
2. Komisionit Disiplinor,
3. FVK-së,
4. Sekretarit të Përgjithshëm të FVK-së,
5. Arkivit të FVK-së dhe
6. Komisionit të Ankesave.